

**TË KYÇEMI DREJT
PËRPJEKËJEVE BOTËRORE
KUNDËR HUMBJES SË
LLOJLLOJSHMËRISË
BIOLOGJIKE**



United Nations Decade on Biodiversity

Projekti: Mbështetja e Republikës së Maqedonisë për revizionin e Strategjisë Nacionale për Llojlojshmëri Biologjike dhe Planin Aksionar dhe përpunimin e raportit të pestë nacional drejt Konventës për Llojlojshmëri Biologjike

Periudha e implementimit: janar 2013 / dhjetor 2014

Financues: Fondi Ekologjik Global - Global Environment Facility (GEF)

Agjencia implementuese: Zyra e Programit të Mjedisit Jetësor e Kombeve të Bashkuara (UNEP) në Vjenë në bashkëpunim me ekspertë dhe organizata nacionale


Shfrytëzues: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Qëllimi kryesorë i këtij projekti është që t'i mundësojë Republikës së Maqedonisë që ta zbatojë revizionin e Strategjisë Nacionale për Llojlojshmërinë Biologjike dhe Planin Aksionar (SNLLBPA) dhe që të përpunojë Raportin e Pestë Nacional drejt Konventës për Llojlojshmëri Biologjike (KLLB).

Aktivitetet projektuese janë fokusuar në **pesë komponentë**:


- 1.** Analiza dhe vlerësimi i gjendjes me llojlojshmërinë biologjike me qëllim të vendosjes më të mirë dhe më reale për mbrojtjen e saj;
- 2.** Përcaktimi i qëllimeve, parimeve dhe prioriteteve kryesore nacionale të Strategjisë me qëllim të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të llojlojshmërisë biologjike dhe integritit të saj në planet sektoriale dhe zhvillimore;
- 3.** Përpunimi i Strategjisë dhe planit aksionar për ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike me zbatimin e indikatorëve për përcjelljen e zbatimit të tyre;
- 4.** Përpunimi i planeve për implementimin e Strategjisë përmes vlerësimit të kapaciteteve dhe resurseve, përpunimi i strategjisë komunikuese dhe aktivitete të tjera;
- 5.** Aktivitetet institucionale përmes vendosjes së trupit operativ koordinues, monitorimi, lajmërimi dhe shkëmbimi i informatave, si dhe përpunimi i raportit të pestë nacional drejt KLLB.

Çka paraqet Konventa për Llojlojshmëri Biologjike?



Me termin llojlojshmëri biologjike nënkuptojmë llojlojshmërinë e gjithë botës së gjallë në tokë-llojlojshmërinë në nivel të ekosistemeve, llojeve dhe gjeneve. Llojlojshmëria biologjike dhe shërbimet e ekosistemeve kontribuojnë në mënyra të ndryshme në mirëqenien e njerëzve.

Numri i rritur i popullatës njerëzore (6.800.000.000) dhe zhvillimi ekonomik i përshpejtuar (industrializimi, urbanizimi, intensifikimi i prodhimtarisë bujqësore, shfrytëzimi i tepruar i burimeve natyrore etj.) po e shpejtojnë trendin e humbjes së llojlojshmërisë biologjike, sidomos në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI.



Konventa e Llojlojshmërisë Biologjike paraqet kontratë ndërkombëtare e nënshkruar nga 193 vende të cilat u pajtuan se llojlojshmëria biologjike është me interes të përbashkët për njerëzimin. Ata u zotuan se do të bashkëpunojnë me qëllim të ruajtjes së vendbanimeve, llojeve dhe gjeneve, do ta ndryshojnë shfrytëzimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme, dhe do të garantojnë se përfitimet nga burimet gjenetike, shpërndahen në mënyrë të barabartë në nivel lokal, nacional dhe global.

Zbatimi efikas i obligimeve të Konventës për Llojlojshmëri Biologjike varet nga efikasiteti i aksioneve të cilat zbatohen në nivel nacional.

Në vitin 2010, analizat e kryera në Shqyrtimin Global të Llojlojshmërisë Biologjike (Global Biodiversity Outlook 3) vërtetojnë se humbja e tri komponentëve kryesore të llojlojshmërisë biologjike vazhdon edhe më tej, e me këtë, qëllimi i vendosur që deri në vitin 2010 të parandalohet humbja e llojlojshmërisë biologjike, nuk u realizua. Si arsye e kësaj paraqitet „Ndërmarrja e pamjaftueshme dhe jo proporcionale e aksioneve për zbatimin e KLLB të cilat kanë të bëjnë me trusnitë/kërcënimet mbi llojlojshmërinë biologjike” dhe „integrimi i pa mjaftueshëm i çështjeve për mbrojtjen e llojlojshmërisë biologjike në politikat, strategjitë dhe programet më të gjëra, si dhe përfshirja e pa mjaftueshme e shkaqeve themelore për humbjen e llojlojshmërisë biologjike.

- Nga 1200 shpezë të ujit me tendenca të njohura të popullatave, 44% janë në rënie.



- Popullata e shpezëve të cilët jetojnë në tokë bujqësore në Evropë janë zvogëluar mesatarisht për 50% nga viti 1980.

- Popullata e 42% e të gjitha llojeve të amfibeve është në rënie.

- Vlerësimet preliminare tregojnë se 23% të llojeve të botës bimore janë të kërcënuara.

- Pyjet, të cilat për momentin përbëjnë rreth 31 % të sipërfaqes tokësore, përfshijnë më tepër se gjysmën e llojeve bimore dhe shtazore në Tokë. Humbja neto e pyjeve është zvogëluar dukshëm (në Evropë sipërfaqet pyjore vazhdojnë të zgjerohen) por kjo nuk do të thotë se është ngadalësuar edhe humbja e llojllojshmërisë biologjike e pyjeve globale.

- Më tepër se 40 % e rrjedhjeve të lumenjve botërorë janë penguar me diga të mëdha.

- Lënia e Përvojave bujqësore tradicionale mund të shkaktojë humbje të fushave kulturore dhe llojllojshmërinë biologjike karakteristike për to.



- Fragmentimi i lumenjve është gjithnjë e më i madh, më të fragmentuar janë lumenjtë në rajonet industriale në SHBA dhe Evropë. Nga 292 sisteme të mëdha të lumenjve, dy të tretat janë me fragmentim të mesëm ose të lartë me ndërtimin e digave dhe rezervuarëve.

- Në nivel global, numri (mbi 120.000 zona) dhe sipërfaqja (rreth 12.2%) nën mbrojtje ligjore, është rritur. Megjithatë, një numër i madh i zonave me rëndësi të posaçme për llojllojshmërinë biologjike janë jashtë rrjetit ekzistues të zonave të mbrojtura. Për këtë arsye, qëllimi për mbrojtjen e së paku 10% të rajoneve ekologjike botërore-qëllimi i të cilave është ruajtja e një mostre përfaqësuese të llojllojshmërisë biologjike – është larg nga realizimi.

Me qëllim të parandalimit të humbjes së llojllojshmërisë biologjike, nevojitet ndërmarrja e aksioneve të cilat i trajtojnë arsyet themelore të humbjes së saj, e jo vetëm simptomat. Kjo është çështje komplekse ndër sektorësh e cila kërkon vullnet politik, planifikimin e zhvillimit ekonomik me kompromise reciproke.

Pse nevojitet strategjia për llojlojshmëri biologjike?

Në kuadër të Konventës për Llojlojshmëri Biologjike, ndërsa në drejtim të zbatimit të saj të suksesshëm, është definuar koncepti i strategjisë nacionale për llojlojshmëri biologjike dhe plani aksionar (SNLLBPA) si instrument integruar, shumë -sektorial, pjesëmarrës për planifikimin e mbrojtjes së llojlojshmërisë biologjike në nivel nacional.

SNLLBPA siguron: forumin për debatin e çështjeve të ndërlidhura me ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike dhe formimin e vizionit të përbashkët; kornizën për negocimin dhe ndërtimin e konsensusit për çështje prioritare me interes të përbashkët; planin për zbatimin e aksioneve për rritjen/përforcimin e kapaciteteve, njohurive, institucioneve dhe teknologjive për çështje prioritare; dhe ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve të organizatave dhe institucioneve të cilat direkt janë të kyçura në ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike.

Procesi i përsëritur i zhvillimit, revidimit dhe zbatimit të SNLLBPA

SNLLBPA është proces përmes të cilit vendet i planifikojnë aksionet e nevojshme me qëllim të kapërcimit të pengesave për ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike dhe që të bëhen ndryshimet e domosdoshme. Me fjalë të tjera, planifikimi i mbrojtjes së llojlojshmërisë biologjike është proces ciklik dhe adaptues përmes të cilit njohuritë e reja shkencore për llojlojshmërinë biologjike dhe monitorimit të realizuar dhe vlerësimi i secilës fazë të implementuar të strategjisë, analizohet dhe bëhet revidimi i saj periodik, me ndërmarrjen e hapave të njëjtë sikur edhe gjatë përpunimit të strategjisë. Çdo shtet zhvillon trajtim të vet për prezantimin e SNLLBPA varësisht nga kushtet dhe burimet specifike në shtet. Njëkohësisht, kjo strategji është gjithnjë e më relevante për zbatimin e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare nga sfera e mbrojtjes së natyrës të cilat japin kontribut të madh për menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të llojlojshmërisë biologjike, siç janë: Konventa e Ramsar-it, e Bon-it, e Bern-it, CITES, Konventa për Trashëgimi Botërore e të tjera.

Cilat janë palët e tanguara?

Edhe pse procesin e përpunimit/revidimit dhe implementimit të SNLLBPA duhet ta udhëheqë një trup përgjegjës në nivel nacional (në Maqedoni ky është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor), përfshirja e një numri të madh të palëve të tanguara relevante qysh në procesin e përpunimit ose të revidimit është i domosdoshëm me qëllim të implementimit efektiv të SNLLBPA, në të ardhmen.

Pjesëmarrja e publikut kërkon shumë kohë dhe mjete, por ka përfitime të disahershme – përmes kyçjes së palëve të tanguara bëhet ndërlidhja e procesit të planifikimit dhe implementimit; mundësohet qasja për një numër të madh të informatave dhe njohurive; ngritet vetëdija publike; ndërtohet konsensusi dhe maksimalisht bëhet harmonizimi i politikave për çështjet e ndërlidhura me ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike.

KLLB definon pesë grupe kryesore të palëve të tanguara: institucionet shtetërore, (ministri dhe agjenci të ndryshme, bashkësia shkencore, organizatat joqeveritare, sektori privat dhe bashkësitë lokale).

Megjithatë, gjatë identifikimit të palëve të tanguara duhet pasur parasysh gjithë ata:

- Të cilët kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë juridike ose administrative për ruajtjen e llojlojshmërisë biologjike (p.sh. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujrave, vetëqeverisjet lokale dhe subjektet për menaxhimin me zonat e mbrojtura)
- Të cilët ndikojnë mbi llojlojshmërinë biologjike (ndërmarrjet publike për pyjet, ujrat, livadhet, transportin, agjencitë për planifikimin e hapësirës, energjetika e të tjera)
- Të cilët posedojnë njohuri, përvoja dhe ekspertizë dhe që mund të japin kontribut në revidimin/përmirësimin dhe zbatimin e SNLLBPA
- Të cilët mund të jenë të tanguar nga masat në dokumentin e sjellur strategjik (p.sh. Ministrinë dhe agjencitë përgjegjëse për zhvillimin e energjetikës dhe transportit)
- Të cilët mund të jenë të tanguar nga gjendja dhe trendi i llojlojshmërisë biologjike



Obligimet e Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen e llojlojshmërisë biologjike

Republika e Maqedonisë e ratifikoi Konventën për Llojlojshmëri Biologjike në dhjetor të vitit 1997, ndërsa me këtë u obligua dhe përpiqet që ti zbatoj obligimet e KLLB. Neni 6 i Konventës i obligon të gjitha vendet që të përpunojnë strategji nacionale, ndërsa neni 26 rregullisht të dorëzojnë raporte nacionale të cilat do të përmbajnë informata për masat të cilat janë ndërmarrë për zbatimin e KLLB dhe efektivitetit të tyre.

Studimi i gjendjes së llojlojshmërisë biologjike në Republikën e Maqedonisë u përpunua në vitin 2003, ndërsa Strategjia e Parë Nacionale për Llojlojshmëri Biologjike me Plan Aksional të Republikës së Maqedonisë u miratua në vitin 2004.

Deri më tani, Republika e Maqedonisë ka përpunuar katër raporte nacionale për KLLB, si dhe disa raporte tematike. Në vijim është revizioni i strategjisë së parë nacionale me planin aksionar dhe përpunimi i raportit të pestë nacional. Të ardhurat multi-sektoriale me përfshirjen e të gjitha palëve të tanguara do të zbatohet në procesin e përpunimit të Strategjisë.

„Të jetuarit në harmoni me natyrën“

Plani Strategjik për Llojlojshmërinë Biologjike për vitin 2011 – 2020 u soll në vitin 2010, në Nagoja, Japoni nga Konventa për Llojlojshmëri Biologjike. Ky paraqet kornizën ndërkombëtare udhëheqëse dhjetëvjeçare për aksion nga të gjithë vendet dhe subjektet e përfshirë me qëllim që të shpëtohet llojlojshmëria biologjike dhe që të rriten përfitimet e njerëzve nga e njëjta. Ky bën thirrje për vendosjen e qëllimeve konkrete nacionale, angazhimin e të gjithë subjekteve të interesuar dhe kycjen e aspekteve të llojlojshmërisë biologjike në të gjithë sektorët e shoqërisë“. Zbatimi i plotë dhe efektiv i këtij plani strategjik është i mundshme që të arrihet vetëm me përpjekjen e përbashkët të të gjitha vendeve anëtare të KLLB gjatë gjithë dekadës.

Duke e parë nevojën urgjente për të vepruar, Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njëkohësisht e shpalli periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2020 për Dekadë të Llojlojshmërisë Biologjike.

Plani strategjik i llojlojshmërisë biologjike 2011-2020 përfshin vizionin e përbashkët, misionin, 5 qëllime strategjike dhe 20 qëllime ambicioze por edhe të realizueshme, të njohura si Qëllimet e Aiçi-t. Ato ishin të vendosura që të bëhet një hap drejtë zbatimit të vendimeve të Konventës së Palëve dhe arritjes së rezultateve reale të matshme në nivel botëror.

Plani strategjik shërben si një kornizë fleksibile për vendosjen e qëllimeve nacionale dhe rajonale dhe e promovon zbatimin konsekuent dhe efektiv të të tre qëllimeve të KLLB-së.

VIZIONI

„Deri në vitin 2050, llojllojshmëria biologjike do të vlerësohet, do të mbrohet dhe do të përdoret me mençuri, me çka do të mbahen shërbimet e ekosistemit, do të ruhet planeti i shëndetshëm dhe do të sigurohen përfitimet nga njohurit thelbësore për të gjithë njerëzit”.

MISIONI

„Deri në vitin 2020 të ndërmerret aksion efektiv dhe urgjent për të ndaluar humbjen e llojllojshmërisë biologjike me qëllim të sigurimit të ekosistemeve fleksibile që do të vazhdojnë ta furnizojnë njerëzimin me shërbimet themelore, me çka do të sigurohet llojllojshmëria e botës së gjallë të planetit dhe do të kontribuohet në mirëqenien e njeriut dhe çrrënjosjen e varfërisë. Që të sigurohet kjo, do të reduktohen presionet mbi llojllojshmërinë biologjike, do të ripërtërihen ekosistemet, burimet biologjike do të përdoren në mënyrë të qëndrueshme edhe përfitimet që dalin nga përdorimi i llojllojshmërisë gjenetike, do të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë; do të sigurohen mjete përkatëse financiare , do të rriten kapacitetet, do të integrohen çështjet dhe vlerat e llojllojshmërisë biologjike, në mënyrë efektive do të implementohen politikat përkatëse, ndërsa sjellja e vendimeve do të bazohet në bazë solide shkencore dhe në qasje parandaluese”.

Qëllimi strategjik

A

Të tejkalohen arsyet themelore për humbjen e llojllojshmërisë biologjike nëpërmjet të integritit të saj në të gjithë shoqërinë



Qëllimi 1: Rritja e vetëdijes për vlerat e llojllojshmërisë biologjike dhe hapat e ardhshme që do të mund të merren për rruajtjen e saj dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm (më së voni deri në vitin 2020)



Qëllimi 2: Vlerat e integruara të llojllojshmërisë biologjike në strategjitë nacionale dhe lokale për zhvillim dhe zvogëlim të varfërisë, në proceset e planifikimit, si dhe përfshirjen e tyre në sistemet e kontabilistëve (deri në vitin 2020)



Qëllimi 3: Stimulime dhe subvencionet të riformuara të cilat janë të dëmshme për llojllojshmërinë biologjike, eliminimin e tyre, mënjanimin gradual ose riformimin, me qëllim që të sillen në minimum ose mënjanimin e ndikimeve negative, ndërsa zhvillimi dhe zbatimin i stimulimeve pozitive për rruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të llojllojshmërisë biologjike në pajtim me KLLB-në dhe obligimet tjera ndërkombëtare relevante, duke i pasur para sysh kushtet nacionale socio-ekonomike (deri në vitin 2020)



Qëllimi 4: Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm, nëpërmjet hapave konkrete për zbatimin e planeve nga qeveritë, subjektet afariste dhe ato të interesuara në të gjitha nivelet për zhvillim dhe konsum të qëndrueshëm dhe mirëmbajtje të ndikimit nga shfrytëzimi i burimeve natyrore në kuadër të kufijve të sigurta ekologjike (deri në vitin 2020)

Qëllimi strategjik

B

Të zvogëlohen presionet e drejtpërdrejta ndaj llojllojshmërisë biologjike dhe të promovohet shfrytëzimi i saj i qëndrueshëm



Qëllimi 5: Humbja e përgjysmuar ose e minimizuar e të gjitha vendbanimeve natyrore, dhe mbi të gjitha degradim i zvogëluar dukshëm dhe fragmentimi i pyjeve (deri në vitin 2020)



Qëllimi 6: Menaxhimi i qëndrueshëm me burimet detare, miratimin e planeve për ripërtëritjen dhe vendosjen e masave për të gjitha llojet me numër të zvogëluar, mënjanim të peshkimit të tepruar, zvogëlim të ndikimeve negative ndaj llojeve të rrezikuara dhe ekosistemeve të ndjeshme, dhe sjelljen e tyre në kuadër të kufijve të sigurta ekologjike (deri në vitin 2020)



Qëllimi 7: Bujqësi e qëndrueshme, akuakultura dhe pylltaria në drejtim të mbrojtjes së sigurtë të llojllojshmërisë biologjike (deri në vitin 2020)



Qëllimi 8: Ndotje e zvogëluar (së bashku me ndotjen nga nutrientet e tepruara) nëpërmjet të sjelljes së niveleve të cilat nuk janë të dëmshme për funksionimin e ekosistemeve dhe llojllojshmërisë biologjike (deri në vitin 2020)



Qëllimi 9: Lloje të parandaluara indigjene pushtuese të kontrolluara nëpërmjet identifikimit dhe prioritizimit të tyre, kontrollimit ose zhdukjes së tyre dhe vendosjen e masave për menaxhimin me shtigjet për shkak të parandalimit të introdukcionit të tyre (deri në vitin 2020)



Qëllimi 10: Presionet e reduktuara antropogjene ndaj ekosistemeve të ndjeshme siç janë shkëmbinjtë nënujorë koral, si rezultat i ndryshimeve klimatike ose acidifikimi i oqeanëve, me qëllim të ruajtjes së integritetit dhe funksionimit të tyre (deri në vitin 2015)

Qëllimi strategjik

C

Të përmirësohet statusi i llojllojshmërisë biologjike nëpërmjet të mbrojtjes së ekosistemeve, llojeve dhe llojllojshmërisë gjenetike



Qëllimi 11: Sipërfaqe e rritur (të paktën 17% e tokës) dhe zona të përmirësuara të mbrojtura nëpërmjet të sistemeve efektive dhe të menaxhuara në mënyrë të barabartë, ekologjike, reprezentative dhe të lidhura mirë në zonat e mbrojtura dhe marrjen e masave të tjera mbrojtëse të bazuara sipas zonës, si dhe integrimin e tyre në zonat më të gjera dhe ato detare (deri në vitin 2020)



Qëllimi 12: Zhdukje e parandaluar e llojeve të njohura të kërcënuara nëpërmjet përmirësimit dhe ruajtjes së statusit të tyre për mbrojtje (deri në vitin 2020)



Qëllimi 13: Llojllojshmëri gjenetike e qëndrueshme e bimëve të kultivuara dhe kafshëve shtëpiake dhe të egra, së bashku me llojet tjera socio-ekonomike dhe kulturash të vlefshme, nëpërmjet të përgatitjes dhe zbatimit të strategjive për sjelljen e erozionit gjenetik në minimum dhe ruajtjen e llojllojshmërisë së tyre gjenetike (deri në vitin 2020)

Qëllimi strategjik

D

Të rriten përfitimet e llojllojshmërisë biologjike dhe shërbimet e ekosistemit për të gjithë



Qëllimi 14: Ekosistemet e mbrojtura dhe shërbimet themelore sidomos shërbimet në lidhje me ujin dhe ata që kontribuojnë për shëndetin, ekzistencën dhe mirëqenien, duke pasur parasysh nevojat e grave, bashkësitë indigjene dhe ato lokale, të të varfërve dhe atyre të ndjeshëm (deri në vitin 2020)



Qëllimi 15: Ekosisteme të ripërtëritura dhe fleksibilitet i rritur nëpërmjet mbrojtjes dhe ripërtëritjes të paktën 15% nga ekosistemet e degraduara, që do të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre, si dhe ndaj luftës kundër thatësisës (deri në vitin 2020)



Qëllimi 16: Protokollin e Nagojës për qasje në burimet gjenetike dhe ndarje të barabartë të përfitimeve që dalin nga përdorimi i tyre të jetë në fuqi dhe operativ, në pajtim me legjislacionin nacional (deri në vitin 2015)

Qëllimi strategjik

E

Të përmirësohet zbatimi nëpërmjet planifikimit me pjesëmarrje aktive, menaxhimit me njohuritë dhe ndërtimin e kapaciteteve



Qëllimi 17: Strategjia nacionale për llojlojshmëri biologjike me planin aksionar e përgatitur dhe e miratuar në mënyrë efektive, pjesëmarrëse dhe e azhuruar, si instrument politik dhe fillim i zbatimit (deri në vitin 2015)



Qëllimi 18: Respektimin e njohurisë tradicionale, inovacioneve dhe praktikave, në drejtim të mbrojtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të llojlojshmërisë biologjike dhe përdorimin e zakonshëm të burimeve biologjike, por në pajtim me legjislacionin nacional dhe me obligimet relevante ndërkombëtare në drejtim të zbatimit të Konventës (deri në vitin 2020)



Qëllimi 19: Njohuri e përmirësuar, e ndarë dhe e zbatuar për llojlojshmërinë biologjike, vlerat e saja, funksionimin, statusin, trendet dhe pasojat nga humbja e tyre (deri në vitin 2020)



Qëllimi 20: Mjete të rritura financiare nga të gjitha burimet për zbatimin efektiv të Planit strategjik 2011-2020 dhe në pajtim me procesin e konsoliduar dhe të kontraktimit në Strategjinë e mobilizimit të burimeve (deri në vitin 2020)





APOLAIMAGES



Република Македонија
Министерство за животна средина
и просторно планирање



gef GLOBAL ENVIRONMENT FACILITY
INVESTING IN OUR PLANET

